



Dhuna dhe pasojat e saj kanë sjelle një alarm të madh në futbollin shqiptar. Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri është takuar me presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit Armando Duka të martën në mesditë. Gjatë takimit është diskutuar për planin e masave që duhet marrë. Ministri ka premtuar tolerancë zero për ata që do të shkaktojnë incidente dhe se do të garantojë mbarevajtjen e të gjitha takimeve të kampionatit. Një plan konkret masash i koordinuar mes dy institucioneve do të vihet në punë për të siguruar mbarevajtjen e ndeshjeve. Pjesë e stafit përgjegjës për sigurinë në fushat e blerta do të jenë efektivet e policisë dhe të deleguarit e federatës së futbollit. Një tjetër pikë e diskutuar nga dy zyrtarët është edhe për zgjedhja e fushave ku është e mundur që të garantohet ruajtja fizike e lojtareve, arbitrave, zyrtareve por edhe e tifozëve të pranishëm në stadione.